3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

**SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE**

- Shtojca 1. Formulari i Ofertës .....
- Shtojca 2. Lista e Çmimeve të Sherbimeve .....
- Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës .....
- Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial.....
- Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike .....
- Shtojca 6. Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit .....
- Shtojca 7. Termat e referencës
- Shtojca 8. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve .....
- Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....
- Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit .....
- Shtojca 11 - Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak) .....
- Formulari 12 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)
- Shtojca 13 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)
- Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
  - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
    1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
    2. Njoftimin e Kontrates;
    3. Kriteret e Përzgjedhjes;
    4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
    5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
    6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
    7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
  - (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
  - (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**

\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Shërbimet)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					



---

<b>Datë</b> _____	
-------------------	--

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

**Shtojca 4.**

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit****Nënshkrimi****Vula**

---

## Shtojca 5.

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

---

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: **“Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të shërbimit,**

**Bashkia Belsh”.**

**Afatet e ekzekutimit: deri me 31.12.2023**

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
1	<i>Blerje shërbimi hartim projekti “ Ndertimi i ambjenteve për zyra te Bashkisë Belsh”.</i>	<b>1 663 766</b>	Bashkia Belsh	30 dite

---

## Shtojca 7

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### TERMAT E REFERENCES

## 1. VENDNDODHJA

Belsh, Zona Gjeografike: Bashkia e re e Belshit kufizohet në veri me bashkinë Peqin, në lindje me bashkinë Cërrik, në jug me bashkinë Kuçovë dhe në perëndim me bashkinë Lushnje. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Belshit. Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 19,503 banorë dhe densitet prej 99.28 banorë për km<sup>2</sup>, ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki ka një popullsi prej 32,389 banorë dhe densitet prej 168.88 banorë për km<sup>2</sup>. Sipërfaqja e bashkisë së re është 196.44 km<sup>2</sup>. Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Belsh, Grekan, Kajan, Fierzë dhe Rrasë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Elbasanit dhe qarkut të Elbasanit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 34 fshatra.

## 2. PERSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Godina ezistuse e Bashkise Belsh eshte ndertuar rreth viteve 70 dhe eshte pershtatur per objekt per zyrat e bashkise ne vitet 90, deri ne vitin 2015 ka qen nje objekt funksional per shake se ambjente e brendshme ishin te mjaftueshme per funksionimin e zyrave per ato sherbime. Pas reformes adiministrative te vitit 2015 me bashkimin e 5 njesive administrative aktuale si Belsh, Kajan, Fierze, Grekan dhe Rrase si dhe me decentraizimin e kompetencave per vetqeverisjen vendore ku ka marre shum funksione admininstrata e qeverisjes vendore dhe me rrijeten e burimeve njerezore dhe kapacitetin per krijimin e drejtorive te reja, kjo Godine nuk eshte e pershtatshme per te perballuar kete fluks sherbimesh, ne keto ambjente ku nje pjes e ketyre drejtorive eshte e shperndare ne ambjente te tjera provizorisht si ne ambjentet e Spitalit Belsh, Vatra e Kulutres, etj


Godina ekzistese eshte 3 kat e ndertuar me mure perimetrale 33 cm me tulla te plota, pa kolona mbajtese me nje siperfaqe ndertimi per kat 142.09 m<sup>2</sup>, me 4 ambjente per zyra ne cdo kat dhe 1 tualet, ku kjo godin pjeserishte eshte e amortizuar, e cila ndodhet ne qender te qytetit te belshit e rrehtuar nga objektet private dhe nuk ka ambjente te lira publike ku te kete akses per krijime e sporteleve te reja te gjendjes civile, zyres se aplikimeve per pashaporte dhe karta te idnetitetit, adises, ambjente te gjerberta si dhe vend parkimet te automjetve per punonjesit e adiminstrates.

Gjatë viteve të fundit ky objekte eshte amortizuar dhe ka probleme dhe nga një vlerësim paraprak rezulton se;

- a) Fasadat janë të dëmtuara;
- b) Vettrat e dritareve te amortizuara
- c) Sistemi dhe rrjeti elektrik i brendshem shfaq gjithmon probleme me mbingarkesen
- d) Sistemi hidraulik i furnizimit dhe shkarkimit te ujrave eshte i amrtizur
- e) Sistem e aspirimi kjo godin nuk ka dhe sistemi i ngrohje-ftohje shfaq shpesh probleme
- f) Telekomunikacion (linja internet, telefoni, tv kabllor) eshte e gjitha ne fasade.
- g) Xokoli i nderteses nuk eshte mirembajtur,
- h) Fasada eshte trajtuar jo njetrajtesisht dhe me nderhyrje ne shtresat e dyshemese,
- i) Katet e mesiperm kane problem me gjendjen e pergjithshme te suvase e cila rezulton ne mase te madhe e amortizuar.
- j) Nderhyrjet e mbylljes apo tentativat e riparimit te fasades ne katet e siperme jane bere ne kohe te ndryshme ndaj dhe jane te palidhur ne aspektin cilesor dhe funksional me njeri tjetrin.
- k) Streha e catise apo parapeti i tarraces eshte pjeserisht I amortizuar duke perbere problem per ujrart, fasaden dhe rrezik per kalimtare.

---

### 3. FOTOGRAFI TE GJENDJES EKZISTUESE





#### **4. PERSHKRIMI I OBJEKTIT TE RI TE PROPOZUAR**

Prona ku do te zhvillohet te ndertohet godina e re e Bashkise Belsh ndodhet ne lindje te qytetit, ne nje zone panoramike qe ka perball liqenin e belshit dhe qendren e qytetit.

Ky obejkt do te kete akses me rrugen kryesore dhe ka te ndertuar lidhjen me infrastrukturen inxhinierike si ndricimin rrugor, kuz lagja Tafan, parkimin publik, ndertimin e shetitores dhe korsise se bicikletave dhe krijimin e ambjenteve te gjelberta.


Nisur nga nevoja per ambjente te bollshme per 10 departamnete dhe zyra vartese te tyre, kerkojme te krijohet nje planimetri funksionale te ambjenteve te bredshme ku te jene te pershtshme per sportele pritese, Salla e Keshillit Bashkiak, zyra Kryetarit te Keshillt, zyra Kryetarit te Bashkise, salla per mbledhje, zyrat nenkryetareve, zyrat e drejtoreve te departamentve, gjithashtu zyra per nenpunesit e departamenteve perkatese.

Kjo godin duhet te ket nje harmonizim ne aspektin arkitektonik te fasadeve te jashtme duke ju pershture rikualifikimit te qendres se qyteti dhe duke ruajtur vlerat arkitektonike dhe kulturore te zones sone .

Koncepti për godinën e re duhet te jet nje trupe duke shfaqur formën katrore ku te nderlidhet me nje shesh public perpara dhe shkalle qe te ket akses me shetitoren dhe ambjentet shlodhese qe ndodhen ne kete zone.

#### **5. POZICIONIMI I PRONES NE HARTE**





## 6. HARTIMI I PROJEKTIT

### ❖ Standardet

Projekti i kompletuar i paraqitur për objektin:

*“NDERTIMI I AMBJENTEVE PER ZYRA TE BASHKISE BELSH”*

Projekti për *“Ndertimi i Ambjenteve për Zyra të Bashkisë Belsh”*, duhet të hartohet mbështetur dhe në zbatim të **Planit të Përgjithshëm Vendor Belsh, akteve ligjore apo nënligjore në fuqi për Kushtet Teknike të Projektimit** duke marrë në konsideratë kushtet dhe kriteret e veçanta në rastin e projektimit apo zbatimit të ndertimi të rrugëve rurale, të marrë në konsideratë Kushtet Teknike të Zbatimit që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë si dhe Standardet në fuqi për normat dhe kriteret specifike të projektimit si dhe ndjekja e procedurave deri në miratimin e lejes së ndërtimit.

Është përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

Hartimi i preventivit do të realizohet në përputhje me cmimet e referencës do të jenë sipas legjislacionit në fuqi (Manuali Teknik i Çmimeve V.K.M nr. 629, datë 15.07.2015).

### ❖ Dorëzimi i Projektit

---

Projekti i paraqitur duhet të kalojë në këto faza:

Hartimi i Projektit duhet të përmbillet brenda një afati prej 30 ditësh. Projekt zbatimi do të përmbajë të gjithë materialin e përmendur mësipër.

### ❖ Dokumentacioni përfundimtar duhet të përmbajë:

- Azhornimin Topografik te Terrenit;
- Planvendosjet ne shkallen 1:2500 ne formatin A3 dhe A2, me te gjitha koeficientet e treguesit te zhvillimit ne perputhje me ligjin Nr. 107/2014, date.31.07.2017, VKM Nr. 408, date 13.05.2015 si dhe PPV-ne Belsh per te bere te mundur kerkesen e perputhshmerise se projekt zbatimit si dhe aplikimin per leje ndertimi ne portalin e-leje;
- Projektin Arkitektonik sipas kerkesave te projektit ne kete detyre projektimi ne formatin A3;
- Relacioni Arkitektonik;
- Projektin Konstruktiv sipas kerkesave te projektit ne kete detyre projektimi ne formatin A3;
- Relacioni Konstruktiv;
- Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;
- Relacioni konstruktiv;
- Projektin Elektrik ne formatin A3;
- Relacioni i Elektrik
- Projektin i Instalimeve hidro-sanitare, Termoteknike - Kondicionimi “HVAC”, Aspirimit dhe Instalimeve mekanike te tjera ne formatin A3;
- Relacioni i Instalimeve hidro-sanitare, Termoteknike - Kondicionimi “HVAC”, Aspirimit dhe Instalimeve mekanike te tjera.
- Projektin e rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit ne formatin A3;
- Reacionin e rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit
- Projekti i MNZ ne formatin A3;
- Relacioni i MNZ;
- Grafikun e Punimeve te detajuar sipas zërave të punës;
- Preventivin e Punimeve;
- Raportin e Auditimit te Energjise;
- Çertifikata e Performances se Energjise;
- Raporti Paraprak i VNM-se;
- Studimi gjeologjik
- Studimi sizmik
- Rekomandime për materialet e ndërtimit që do të përdoren.

Gjithashtu projektuesi duhet të paraqesë:

- Liçenca e inxhinierit gjeodet + Deklarata e Pergjegjesise Profesionale + Polica e Sigurimit;
- Liçenca e arkitektit + Deklarata e Pergjegjesise Profesionale + Polica e Sigurimit;
- Liçenca e inxhinierit konstruktor + Deklarata e Pergjegjesise Profesionale + Polica e Sigurimit;
- Liçenca e inxhinierit Elektrik/Energjitik + Deklarata e Pergjegjesise Profesionale + Polica e Sigurimit;
- Liçenca e inxhinierit Mekanik/Energjitik + Deklarata e Pergjegjesise Profesionale + Polica e Sigurimit

- Liçenca e inxhinierit Elektronik + Deklarata e Pergjegjesise Profesionale + Polica e Sigurimit
- Liçenca e inxhinierit gjeolog + Deklarata e Pergjegjesise Profesionale + Polica e Sigurimit;
- Liçenca e inxhinierit sizmolog + Deklarata e Pergjegjesise Profesionale + Polica e Sigurimit;
- Liçenca e inxhinierit per hartimin e projektit te MNZ + Deklarata e Pergjegjesise Profesionale + Polica e Sigurimit;
- Liçenca e inxhinierit te mjedisit + Deklarata e Pergjegjesise Profesionale + Polica e Sigurimit;
- Çertifikate per Audituesin Energjistik + Deklarata e Pergjegjesise Profesionale + Polica e Sigurimit;

### ❖ **Rekomandime për projektuesin**

- Projektuesi duhet të përdore cdo dokumentacion ekzistues në lidhje me gjurmen ekzistuese do të ndërtohet ky objekt.
- Konsulentit do t'i vihet në dispozicion edhe një Program Standart i ambjenteve ku janë përcaktuar standartet minimale të ndertimi te rrugeve.
- Cilësia e projektimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standartin e kërkuar.
- Projektuesi duhet të hartojë projektin në përputhje me Ligjin nr.8402, datë10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

### ❖ **Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar**

Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin Kontraktor. Stafi që kërkohet duhet të mbulojë:

- Inxhinier Gjeodet;
- Arkitekt;
- Inxhinier Konstruktor/Strukturist;
- Inxhinier Elektrik/Energjistik
- Inxhinier Mekanik/Energjistik
- Inxhinier Elektronik
- Inxhinier Mjedisi;
- Inxhinier per hartimin e projekteve te mbrojtjes ndaj zjarrit;
- Inxhinier Gjeolog;
- Inxhinier Sizmolog;
- Preventivues;
- Staf mbështetës për fushat e mësipërme;

### ❖ **Raportimi/paraqitja**

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të merren parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, dhe dispozitat nënligjore në zbatim të tij si dhe ndjekjen e procedurave ligjore deri në miratimin e Lejes së Ndërtimit nga Autoritetet.

Raportet dhe dokumentat duhet të jenë në 5 (pesë) kopje, në gjuhën shqipe dhe të jenë te printuar me ngjyra. Vizatimet duhet të jenë të lexueshme në formatin “dwg” (AutoCad 2006-2020).

---

Ne projekt do te paraqiten te gjitha detajet, skicat dhe udhezimet e domosdoshme per realizimet e punimve.

Ne projekt do te shenohet vend - depozitimi i mbetjeve dhe treguesit e distancave nga secili rruge deri tek venddepozitimi i mbetjeve.

Të gjitha materialet do të dorëzohen në hard-copy (në 5 kopje te firmosur dhe vulosur me vule te njome) si dhe te dorezohet i vulosur elektronikisht me vule dixhitale nga drejtuesi ligjor.

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

---

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas percaktimeve të bëra në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (**2020-2021-2022**) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar në kontratë.

2.2.2 Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2020, 2021, 2022) që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, Dega e Tatimit Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që*

---

detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar);prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit te QKB, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

***Shënim:** Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.9. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,**, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin... ”.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për funizime të mëparshme të ngjashme, në një vlerë **jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës**, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a. Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës

b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, **të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë, Liçences profesionale për shoqërinë, sipas VKM nr. 943, date 28.12.2016, lidhja 2, e vlefshme për kategorite ne fushat e studimit dhe projektimit ne ndertim lëshuar nga MIE dhe/ ose MZHU dhe/ose nga cdo Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim , për këto kategori:

### **Kat. 2. PROJEKTUES ARKITEKT**

a-Projektim arkitekturor për objekte banimi-objekte industrial-objekte turistike

c-projektim interiere

d- Projektim peisazhi, sistemim siperfaqe te gjelberta, lulishte e parqe.

### **Kat. 3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR**

a- Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

#### **Kat. 4. PROJEKTUES INSTALATOR**

a-Projektim te instalimeve hidro-termosanitare;

b-Projektim te instalimeve termoteknike- kondicionimi, si dhe te impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme.

c-Projektim te linjave e rrjeteve elektrike, per objekte civile e industriale;

d- Projektim te sistemeve komplekse te telekomunikacionit

e-projektim te sistemeve te funizimit me gaz.

f-projektim te sistemeve kunder zjarrit .

h- projektim i impjanteve ngritese e trasportuese(ashensor, shkallle levizese)

j-Projektim te rrjeteve te telefonise, citofonise, fonise, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit te zjarrit, etj., per objektet civile dhe industriale.

#### **Kat. 8. PROJEKTUES GJEODET**

a. Rilevime inxhinierike

b. Rivelime inxhinierike kadastrale

#### **Kat. 9. STUDIMGJEOLIGO-INXHINERIK-HIDROGJEOLOGJIK**

a-studim/vleresim gjeologoinxhinierik i truallit per objekte civile-ekonomike deri ne 5kate.

#### **Kat.12.STUDIME TE SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE(VETEM PER SHOQERI /PERSONA JURIDIK)**

b-studime /vleresime gjeologo-sizmike per trojet ku ndertohen objektet civile, sociale kulturore.

*(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

**Shënim:** *Për pikën si më sipër operatoret ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.9. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,** të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin... ”.*

**2.3.3** Një punësim mesatar të paktën **10 ( dhjete )** personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen Mars-Gusht2023;

**a.** Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore per periudhen e fundit te deklaruar.

**b.** Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohe nga legjislacioni ne fuqi per periudhen e fundit te deklaruar, shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

**Shënim:** *Për pikën si më sipër operatoret ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.9. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,** të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin... ”.*



---

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet të ketë si drejtues teknik të përfshirë në Licencën e Shoqërisë stafin si më poshtë, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome, Licence profesionale individuale dhe të jenë të përfshirë në Listpagesën e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shendetesore dhe TAP, të shoqërisë sipas formularit e-sig për muajin Mars- Gusht 2023 të deklaruar:

- 1 (nje) Arkitekt;
- 1(nje) Inxhinier Ndertimi ;
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik;
- 1 (nje) Inxhinier gjeodet;
- 1 (nje) Inxhinier gjeolog;
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik;
- 1 (nje) Inxhinier Gjeofizik/Sizmolog;
- 1 (nje) Inxhinier Mjedisi;

**Shënim:** Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.9. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit,** të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin... ”.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të ketë stafit ndihmes si më poshtë , vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome, Licence profesionale individuale dhe të jenë të përfshirë në Listpagesën e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shendetesore dhe TAP, të shoqërisë sipas formularit e-sig për periudhën Mars-Gusht 2023 të deklaruar:

- 1 (nje) preventivues
- 1 (nje) Inxhinier Elektronik

**Shënim:** Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.9. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit,** të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin... ”.

**2.3.6** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e shoqërisë personel të kualifikuar/certifikuar:

-1(një) Auditues Energjitik I certifikuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë për të kryer auditime në ndërtesë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, diplomë/certifikatë, CV dhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë për periudhën Mars-Gusht2023.

-1(një) punonjës të pajisur me certifikatë si "Ekspert Privat Zjarrëfikës" në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 152/2015 datë 21.12.2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, CV, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Mars-Gusht 2023.

**Shënim:** Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.9. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit,** të gjithë

---

*dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin... ”.*

**2.3.7** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe Pajisjet Gjeodezike si më poshtë:

-1(një) Pajisje GPS

-1(një) Pajisje Total Station V

Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronesisë së qiradhënsit origjinal ose fotokopje e noterizuar).

***Shënim:*** *Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.9. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin... ”.*

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës , duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354,datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shtojca 9.**

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

<b>Emri i nënkontraktorit të propozuar</b>	<b>NIPT –i</b>	<b>Përqindja e nënkontraktimit</b>	<b>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar</b>


- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

<b>Emri (at) e subjekteve</b>	<b>NIPT-i</b>	<b>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</b>	<b>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</b>

## **Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

### **A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

<b>Deklarata</b>
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
